



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LIGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 8

Prishtinë, më 08 qershor 2011

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-302

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENSHME, SIGURI DHE
MBIKQYRJËN E FORCËS TË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Fatmir Xhelili, Ganimete Musliu, Goran Marinković, Anton Quni, Vjollca Krasniqi dhe Rasim Demiri, anëtarë të Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Haxhi Xhemajli.

Nga stafi këshillues i komisionit morën pjesë: Avni Arifi dhe Naim Hoxha.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës

Takim me ministrin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Agim Çeku dhe ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi;

Kryetari i Komisionit- konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës, duke përshëndetur ministrin e FSK-së z. Agim Çeku, ministrin e MPJ-së z. Bajram Rexhepi, zv/komandantin e Forcës së Sigurisë Gjeneral-major Rrahman Rama me bashkëpunëtorët e tyre. Këtë takim e kemi thirrur si komision mbikëqyrës që jemi për këto dy ministri dhe tema e këtij takimi sot është rreth memorandumit të bashkëpunimit mes tyre rreth të cilit ka pasur debate kohet e fundit.

Fillimisht do të dëgjojmë vlerësimet e dy ministrave rreth kësaj çështje e pastaj do të kemi një deklaram të përbashkët mendoj. Fjalën e ka ministri i Çeku

Ministri Agim Çeku - Ju faleminderit z. kryetar dhe anëtarë i komisionit, për këtë takim, mendoj ka qenë i nevojshëm, pasi kjo çështje ka shkaktuar shqetësime këto ditë. Me lejoni fillimisht të prezantoj bashkëpunëtorët, z. Shemsi Veseli, zv/ministër i cili sot është në ditën e parë të punës. Pastaj Gjeneral Rama, Sekretari i Ministrisë z. Shkëlzen Syla, zj Krenare Sogojeva- shefe e departamentit ligjor në ministri dhe Besa Kabashi-këshilltare e Ministrit.

Sa i përbëtë draft-memorandumit ai është një synim një përpjeke që të fuqizohet FSK, dhe ky është një draft në fazën shumë fillestare, por kemi pasur një hartë kohore për miratimin e tij, por dalja në publike i ka përshpejtuar këto procese. Ky draft memorandum është legjitim i bazuar në kushtetutë dhe ligje në fuqi. Në si model kemi marr doktrinë e shumë ushtrive demokratike. Çdo ushti ka në doktrinë e saj ka këto funksione, si mbrojtja e vendit, asistimi i autoriteteve civile, pastaj pjesëmarrjeve në misione paqeruajtëse dhe detyrat ceremoniale. Dhe nuk bëhet këtu fjalë për ndonjë praktike totalitare por shumë demokratike. Ja për shembull KFOR-i i cili përbehet nga ushtritë ma demokratike. KFOR-i kryesisht merret me ndihmë autoritete civile, si patrullime të kufirit, patrullime, mbrojtje të kishave etj. Dhe në jemi nisur nga kjo praktike që të bëjmë çdo punë që kërkohet nga në. Ky është një projekt në kohën e duhur sepse tani FSK-ja është afër përmbushjes së kapaciteteve civile. Është përpjekje ligjore sepse është i mbështetur plotësisht në Kushtetutë dhe ligjin për FSK. Këto akte e përkufizojnë mandatin e FSK-se si force e sigurisë e armatosur lehtë që ndihmon autoritetet civile në rast krizash, katastrofash natyrore apo në rast emergjencash tjera.

Memorandumi është një dokument që në mos ti hyjmë ndryshimit të ligjeve por të kemi një dokument bazë që avanco statusin e FSK-së i cili është i bazuar edhe në strategjinë e sigurisë kombëtarë. Në si Ministri e FSK-së kemi memorandume me mistrinë e kthimit dhe ndihmojmë shumë në procesin e kthimit të personave sidomos për pastrimin e gërmadhave. Memorandum me mistrinë e ambientit ku kontribuojmë me shume aktivitete për pastrimin dhe ruajtën e ambientit, mistrinë e shëndetësie ku ekipet tona janë vazhdimisht në shumë zona e sidomos në enklava për të ofruar shërbime qytetarëve, me ministrinë e infrastrukturës ku FSK-ja ka ndihmuar në hapjen e shumë rrugëve. Përpjekja tjetër më këtë memorandum ka qenë të definohet statusi i FSK në fushën e sigurisë. Dhe roli i saj nuk është krejt i qartë. Kjo ka qenë një përpjekje praktike sepse të gjitha kapacitetit për mbrojtje civile në i kemi në regjimentin për mbrojtjen civile. Aty kemi njësitë e dominimit, kërkim- shpëtimit, zjarrfikës por bërthama kryesore e FSK-së është Brigada e Reagimit të Shpejtë, e cila ka mbi 1200 pjesëtare të trajnuar dhe të gatshëm për të reaguuar.

Është kërkesë e NATO-së që çdo force të jetë ndërvepruese dhe fleksibile, që do të thotë ti kryej të gjitha detyrat që kërkohen. Ky projekt është një përpjeke për fuqizimin e sektorit të sigurisë në Kosovë, e assesi për të suspenduar kompetencën e dikujt apo për policizimin e FSK-së. Në kuadër realizimit të prioritetëve që kemi si MFSK në kemi pasur një takim me 5 prill 2011 me gjithë stafin komandues të KFOR-it, ku jemi dakorduar për mundësinë e avancimit me disa detyra shtesë për FSK-në. Ky memorandum është vetëm një draft dhe pasi të hartohet varianti i fundit do të konsultohemi me faktorin ndërkombëtar dhe pas miratimit nga ana e tyre do të shkoje për

miratim në Këshillin e Sigurisë, do të vijë edhe këtu para jush. Herët a vonë FSK-ja do të këtë këto detyra. Në jemi shumë të përgjegjshëm si ministra për këto zhvillime dhe ju sigurojmë që çdo gjë do të jetë në pajtim me ligjin dhe në shërbim të qytetareve të vendit. Qëllimi është ta fuqizojmë sektorin e sigurisë në Kosovë. Faleminderit për vëmendjen.

Kryetari i Komisionit –Faleminderit z. Çeku, ne si komision që e bëjmë mbikëqyrjen e forcës së sigurisë dhe mustrisë e punëve të brendshme jemi dakorduar që ju të paraqitni pikëpamjet tuaja rreth këtij memorandumi në mënyrë që të hiqen dilemat se a është draft ende apo deri ku ka shkuar procesi. Në nuk jemi vetëm për mbikëqyrje por edhe për ndihmë këtyre institucioneve. Fjalën e ka ministri z. Bajram Rexhepi.

Ministri Bajram Rexhepi-Të nderuar anëtar të komisionit sigurisht që duhet të këtë bashkëpunim mes institucioneve të nivelit qendror edhe lokal. Në na obligojnë edhe disa dokumente strategjike për ndërveprim dhe bashkëpunim siç janë plani për reagim kombëtar dhe konform vendimit të kryeministrit të vendit është ministria e punëve të brendshme ajo që i koordinon këto aktiviteti edhe me ministrinë e FSK-së dhe ministrinë tjera, në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore apo në rast sulmi kimik , pra të kemi plan reagues se kush qka vepron e qka ka mandat. Edhe strategjia e sigurisë kombëtare na obligon që të kemi bashkëpunim mes institucioneve e që në këtë kuadër është edhe memorandumi i paraparë. FSK-ja ka kapacitete të mëdha për reagime si në rast të fatkeqësive natyrore që është dëshmuar edhe në reagimin e përmbajtjeve në Shqipëri, pastaj ka kapacitete në zjarrëfikje, dhe këto kapacitete duhet të përdoren.

Sa i përket këtij draft-memorandumi ky ka qenë një dokument në vija të përgjithshme dhe në bazë të këtyre principeve të bashkëpunimit por jemi pajtuar për disa fusha që të bashkëpunojmë me FSK. Ky draft është iniciuar nga Ministria e FSK-së dhe ajo që ka dalë në media ju siguroje se nuk është e tillë, aty ka pas spekulime dhe të gjithë jemi të interesuar që FSK-ja të arrijë kapacitetet e veta. Memorandumi nuk ka fuqi ligjore dhe nuk e ndryshon mandatin e FSK-së as policisë. Ne të ardhmë do të këtë rishikim edhe të strategjisë kombëtare të sigurisë. Kur të vijë të drafti –final do të dërgohet për vlerësim edhe tek Këshilli i Sigurisë dhe tek Komisioni juaj dhe Kushtetuta dhe ligjet e përcaktojnë saktë kompetencën e secilit institucion dhe këtu ska vend për konfuzion as dilema. Ndoshta ka pas paqartësi në disa formulime dhe nuk kanë qenë formulime të sakte ligjore por kjo në të ardhmë do të përmirësohet. Pra kështu duhet të kuptohet që ne të ofrojmë sigurinë maksimale për qytetarët dhe jo për të forcuar pushtetin e këtyre dy mekanizmave të sigurisë. Ju faleminderit.

Kryetari -Të kuptohemi se Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji për FSK-në është bazë për mandatin e saj. Ky draft-memorandum nuk është në përputhje me nenin 9.3 të këtij ligji ku thotë se forca e sigurisë është forcë e sigurisë e dizajnuar për të kryer detyra që nuk i kryen policia e Kosovës dhe asnjë agjencion tjetër për zbatimin e ligjit në Kosovë për të vepruar ajo autorizohet nga Prania Ndërkombëtare Ushtarake. Ky draft dokument që ka dalë edhe pse inicial ka ngjallur shqetësime dhe në të ardhmen çdo marrëveshje duhet të jetë i bazuar në kushtetute dhe ligje. Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

Rexhep Selimi - Në mbështesim çdo lloj bashkëpunimi mes institucioneve që kanë kompetence ofrimin e sigurisë së qytetarëve. Në kemi përpara disa raporte mediatike dhe këtij draft memorandumit i referohemi si një përmbajtje e dal nga mediat. Në nuk kemi telashe me draft-memorandumin por me përmbajtjen e tij. Në mbështesim memorandumin për bashkëpunim midis dy ministrive përkatëse dhe normalisht po të ishte ky drafti final sigurisht se do të kishim vërejtjet tona dhe në të ardhmen duhet të korrigjohen lëshimet dhe çdo lloj memorandumit duhet të këtë mbështetjen edhe te NATO-s.

Fatmir Xhelili - Përgëzoj ministrat Çeku dhe Rexhepi për këtë iniciativë dhe kjo është obligim duke u bazuar në dokumentet strategjike si në planin e reagimit kombëtarë dhe menaxhimit të emergjencave. Besoi që përpjekja për të ngritë nivelin e reagimit të FSK-së me një memorandum të tillë është edhe kërkesë e kohës. Disa çështje që janë përmendur aty si për shembull që ndalimi i delikuentëve etj, kanë ngjallur reagime të publikut dhe kjo të ardhmen sigurisht se do të korrigjohet dhe mendoj që ky bashkëpunim është i domosdoshëm dhe e përkrahim.

Anton Quni- Këtë takim e marr si shembull të mirë për kontrollin demokratike për Forcën e sigurisë dhe shtensionon shqetësimet e qytetarëve. Lidhur me memorandumin versioni i publikuar nuk ka qene mire i specifikuar dhe mirë i kategorizuar dhe ato shqetësime që u përmenden edhe nga parafolësit si arrestimi i delikuentëve, kontrolli i trafikut i turmave që janë detyra esenciale të policisë së Kosovës. Jam i bindur që këto lëshime do të tejkalohen. Ne si aspirues të trendëve euroatlantike do duhet të kemi të qartë se paraqitja e tepruar e uniformes në vende publike nuk shihet si një gjë e mire dhe këtu kanë qenë shqetësimet e qytetarëve. Sa i përket punës së KFOR-it mendoj se armatat që e përbehen këtë force në vendet e tyre nuk i kryej shumë detyra që i bëjnë në Kosovë. Forca e Sigurisë është dëshirë e qytetarëve që në të ardhmen të jetë ushtria e Kosovës dhe ju të merrni masa për menjanimin e rrezikut nga jashtë se rreziku nuk vjen nga qytetarët e saj.

Rasim Demiri - Ajo që kemi dëgjuar sot është shumë e qartë se është duke u punuar për një bashkëpunim i mirëfilltë mes dy ministrive të cilin unë e përshëndes edhe mbështes angazhimin që po behet për sqarimin rreth dilemave për këtë memorandumit dhe ky sqarim është edhe për të mirën e të gjithë qytetarëve.

Ministri Agim Çeku-Lidhur me disa çështje që ngriti z. Çuni, nuk behet fjalë për angazhime ditore të FSK-së, nuk behet fjale që në ta shohim FSK-në çdo ditë në sheshe e rrugë por vetëm në rast që situata kërkon që policia s'mund ti përballojë vet, dhe vetëm me kërkesë të policisë dhe me miratimin e Pranisë ndërkombëtare ushtarake, mund të shkojë FSK-ja dhe vetëm kur atje është policia e assesi vetëm FSK-ja.

Ministri Bajram Rexhepi- Unë vetëm desha të ju përshëndes edhe falënderoi për përkrahjen tuaj. Grupet Punese do të vazhdojnë me punën dhe ju do jeni të informuar për çdo detaj.

Kryetari- Në si Komision do të përcjellim punën tuaj dhe interes yni është që bashkëpunimi mes këtyre dy institucioneve të jetë në nivel të lartë të zhvillimit dhe në do të vazhdojmë të monitorojmë këtë proces.

Mbledhja përfundoj në ora: 11:00.

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi